

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7951
E enjte, 12 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

Mbi 30 mijë votues nga diaspora aplikojnë për t'u regjistruar për zgjedhje

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD) KA PUBLIKUAR RAPORTIN
MBI MOSEFIKASITETIN E HETIMIT PARLAMENTAR

FAQE 4-5

OPOZITA AKUZON QEVERINË PËR PENGIM NË KOMISIONET HETIMORE



Hulumtuesi i lartë në IKD, Naim Jakaj, ka theksuar rëndësinë e institucioneve të hetimit parlamentar dhe të mekanizmave të kontrollit mbi

pushtetin ekzekutiv në një shtet demokratik. Ai ka thënë se hetimi parlamentar ka rol të jashtëzakonshëm në parandalimin e korrupsionit.

Ndërkaq opozita ka theksuar se pas ardhjes në pushtet të Lëvizjes Vetëvendosje, zhvillimet e komisioneve hetimore parlamentare janë vështirësuar

AKTUALE



**SHTYHET SEANCA PËR LIGJIN
PËR GJUHËT NË MAQEDONINË
E VERIUT** F. 2

**KRYEMINISTRI I RI I SIRISË U BËNË
THIRRJE REFUGJATËVE SIRIANË TË
KTHEHEN** F. 2

**SBASHK-U I REAGON MURATIT:
A KE EDHE NDONJË SULM KUNDËR
PUNËTORËVE TË ARSIMIT?** F. 7


EKONOMI



**QINDRA MILIONA EURO
PËR INVESTIME KAPITALE
MBETEN NË PORTOFOL** F. 8

**KOSTOJA E NDËRTIMIT NË
KOSOVË U RRIËT PËR 0.9 %** F. 8

SPORT




**'DARDANËT' PËRGATITEN PËR
KUALIFIKUESËT, PARALAJMËROJNË
FITORE NDAJ GJEOGJISË** F. 11

**HOVENIERI PËR
PËRGJEGJËSINË
E SULMIT NË VERI:
DO TË GJENDEN
PROVA, POR ENDE
S'I KEMI** F. 3



**PAS SFIDAVE
TË RREZIKSHME,
DEPUTETËT
KËRKOJNË
MBYLLJEN E
"TIK-TOK"-UT** F. 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shtyhet seanca për Ligjin për Gjuhët në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 11 DHJETOR - Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut ka vendosur ta shtyjë seancën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Ligjit për përdorimin e gjuhëve për një datë të pacaktuar.

Në këtë seancë, për të cilën do të vendoset se kur do të mbahet, pritet të marrin pjesë ekspertë të fushës dhe përfaqësues të partive politike, të cilët do t'i paraqesin argumentet e tyre lidhur me kontestimin e Ligjit për Gjuhët. Propozimi për shtyrjen e seancës u bë nga gjykatësja e Gjykatës Kushtetuese, Elizabeta Dukovska, e cila është përgjegjëse për këtë çështje. Kundër këtij vendimi ishte gjykatësja Dobrilla Kacarska, e cila theksoi se gjykata duhet të jetë ajo që jep fjalën përfundimtare.

Ligji për Gjuhët parasheh përdorim të zgjeruar të gjuhës shqipe dhe e përmend atë në mënyrë specifike në nenin 2.

Në hapjen e seancës të mërkurën, gjykatësi Fatmir Skënderi propozoi shtyrjen e seancës për dy javë, me qëllim që të sigurohej prania e dy gjykatësve shqiptarë dhe plotësimi i përbërjes së gjykatës. Propozimi u hodh poshtë me votim, dhe pas kësaj gjykatësi Skënderi lëshoi seancën.

Seanca e së mërkurës filloi me mungesën e dy gjykatësve shqiptarë, Osman Kadriu dhe Naser Ajdari, që bojkotuan procesin.

Nëpërmjet bojkotit, Kadriu dhe Ajdari synojnë ta bllokojnë nisjen e procedurës për këtë ligj. Kjo lidhet me një konkluzion të miratuar nga Gjykata Kushtetuese gjatë viteve 2022 dhe 2023, që kërkon pjesëmarrjen unanime të të gjithë anëtarëve për procedurat që kanë të bëjnë me Ligjin për gjuhët, Marrëveshjen e Prespës dhe Ligjin për Komunikime Elektronike.



Bojkotin nga ana e gjyqtarëve shqiptarë e kishte përmendur më herët Izet Mexhiti, zëvendëskryeministër i parë i Maqedonisë së Veriut që vjen nga radhët e VLEN-it. Me këtë, sipas tij, "vendimi nuk mund të kishte legjitimitet". "Është prononcuar edhe kryetari që duhet të marrin pjesë të gjithë gjykatësit dhe nëse dikush mungon, atëherë nuk ka legjitimitet vendimi", kishte thënë Mexhiti më 6 dhjetor,

duke siguruar se "ligji nuk do të preket". Ndërkohë, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, që udhëheq Frontin Evropian, deklaroi para njerëzve të mbledhur se data e 11 dhjetorit 2024 i rikujton periudhën e vitit 1989 kur, sipas tij, "Millosheviqi suprimoi autonominë e Kosovës". "Të punojmë së bashku. Ne kurrë nuk e kemi kontestuar gjuhën apo kulturën e tyre. Gjithmonë

kemi qenë përkrah tyre, duke kërkuar mënyra për t'i mbrojtur së bashku vlerat tona dhe ato të bashkëqytetarëve tanë maqedonas. Në fund të fundit, jetojmë nën të njëjtin qiell dhe na ngroh i njëjti diell. Ne dëshirojmë që vendi ynë të jetë në paqe dhe i integruar në Bashkimin Evropian", tha Ahmeti, pas vendimit, duke shtuar se pagja nuk duhet të cenohet, dhe vendimet e Kushtetueses nuk duhet të merren në mënyrë të njëanshme.

BDI-ja edhe më herët ka shprehur shqetësim se nëse neni 23, paragrafi 5 i Ligjit për Gjuhët abrogohet, atëherë ai mund të bëhet i pazbatueshëm. Para Gjykatës Kushtetuese në Shkup të pranishëm ishin edhe liderët të tjerë të Frontit Evropian në opozitë, si Zijadin Sela, lider i njërit fraksion të Aleancës për Shqiptarë, si dhe një numër i madh qytetarësh dhe simpatizantësh partiakë.

ShBA-ja i ndan miliarda dollarë Ukrainës para largimit të Bidenit

Uashington, 11 dhjetor - Shtetet e Bashkuara njoftuan se i kanë ndarë Ukrainës 20 miliardë dollarë hua në kuadër të një pakete të mbështetjes prej 50 miliardë dollarësh, për të cilën grupi i vendeve më të industrializuara, G7, ka rënë dakord në verë. Administrata e presidentit aktual, Joe Biden, ka premtuar se do ta ndajë kredinë përpara fundit të vitit për shkak të shqetësimeve se presidenti i zgjedhur, Donald Trump, mund ta ndalë mbështetjen e ShBA-së për vendin në luftë.

Trump, i cili do ta marrë detyrën më 20 janar, ka



kritikuar vazhdimisht ndihmat e ShBA-së për të, por ka thënë, gjithashtu, se do të mbështeste një program të

huadhënies. Ukraina është shumë e varur nga ndihma ushtarake dhe financiare e ShBA-së dhe

Evropës, në luftën e saj kundër pushtimit rus, që ka hyrë tashmë në vitin e tretë.

Një paketë e ndihmës e ShBA-së, në vlerë prej 61 miliardë dollarësh, ka kaluar në prill, por ka të ngjarë që ajo të përfundojë deri në fillim të vitit të ardhshëm.

Kjo bën që kredia prej 50 miliardë dollarësh e G7-s të sigurojë që Ukraina ka fonde dhe armë të mjaftueshme për t'u mbrojtur gjatë pjesës së parë të vitit 2025, nëse Trumpi e ndalon mbështetjen e mëtejshme për të. "Këto fonde të paguara nga të ardhurat e asetëve të pamobilizuara të Rusisë - do t'i ofrojnë Ukrainës

një infuzion kritik të mbështetjes, ndërsa mbrohet kundër një lufte të paprovokuar agresioni", tha sekretarja e Thesarit amerikan, Janet Yellen. Njoftimi për këtë hua vjen pas disa muajsh bisedime midis Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tyre - përfshirë Bashkimin Evropian - për mënyrën më të mirë për t'i përdorur asetet e ngrira ruse, me vlerë qindra miliarda dollarë, pa e shkelur ligjin ndërkombëtar. Thesari tha se Uashingtoni i ka transferuar 20 miliardë dollarë në një fond të Bankës Botërore, e cila do t'i vërë paratë në dispozicion të Ukrainës.

Kryeministri i ri i Sirisë u bënë thirrje refugjatëve sirianë të kthehen

Damask, 11 dhjetor - Kryeministri i ri i Sirisë u bëri thirrje sirianëve që kanë kërkuar strehim jashtë vendit, të kthehen në Siri, pas përmbysjes së presidentit Bashar al-Assad.

Mohammad al-Bashir, i emëruar nga grupet rebele udhëheqës i qeverisë kalimtare, i tha së përditshmes italiane "Corriere della Sera", se një nga synimet e tij të para është "kthimi i miliona refugjatëve sirianë që ndodhen jashtë vendit". "Kapitali i tyre njerëzor, përvoja e tyre do t'i

mundësojë vendit të lulëzojë", tha Bashir në intervistën e publikuar të mërkurën. "Kam një thirrje për të gjithë sirianët jashtë vendit: Siria është tani një vend i lirë që ka fituar krenarinë dhe dinjitetin e saj. Kthehuni! Ne duhet ta rindërtojmë, të rilindemi dhe kemi nevojë për ndihmën e të gjithëve", tha ai.

Regjimi i Assadit në Siri ra më 8 dhjetor, kur pushtetin e mori organizata Hayat Tahrir al-Sham (HTS), e shpallur terroriste nga ShBA-ja dhe aleatë të saj.



Lufta civile gati 14-vjeçare në këtë vend la të vrarë 500 000 njerëz dhe detyroi gjysmën e

banorëve të largoheshin nga shtëpitë e tyre - miliona prej të cilëve gjetën strehim jashtë

vendit.

Pas largimit të Assadit, Siria përballet me pasiguri të mëdha.

Shqetësime ka sidomos për dhunën sektare, edhe pse HTS-ja ka bërë përpjekje t'i sigurojë pakicat fetare se do të jenë të sigurta në Sirinë e re. Komunitetet e ndryshme të vendit, përfshirë të krishterët, kurdët dhe alavitët, presin tani të shohin se çfarë qeverie do të udhëheqë Bashiri.

Kreu i Kishës Katolike, Papa Françesku, bëri thirrje të mërkurën për "respekt të ndërsjellë" midis feve në Siri.

Hovenieri për përgjegjësinë e sulmit në veri: Do të gjenden prova, por ende s'i kemi

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se ende nuk ka prova se kush mund ta ketë kryer sulmin në kanal in e ujit të Ibër-Lepencit në veri të Kosovës në fund të muajit të kaluar, por shtoi se "ne mendojmë se do të gjenden prova".

Shpërthimi i 29 nëntorit në kanal in e ujit në Varragë të Zubin Potokut - prej nga furnizohen me ujë disa qytete dhe termoelektrana të vendit - u shkaktua nga rreth 20 kilogramë eksplozivë, sipas autoriteteve të Kosovës, të cilat e cilësuan atë si më të rëndin në infrastrukturën kritike të vendit që nga lufta e viteve 1998/99.

I pyetur në një intervistë në emisionin "Context" në ATV më 10 dhjetor, se çfarë dihet



deri tani rreth sulmit, Hovenieri e përsëriti se është ende shumë herët të thuhet. "Është ende shumë herët dhe, siç e kam thënë javën e kaluar, që Shtetet e Bashkuara të jenë në gjendje të atribuojnë përgjegjësinë, duhet të kemi

një varg mjaft të qartë provash. Ne mendojmë se do të gjenden prova, por ende nuk i kemi. Pra, hetimet po vazhdojnë; po kryhen nga autoritetet e Kosovës", tha ai. Hovenier - i cili po përfundon mandatin e tij në Kosovë në

fund të dhjetorit dhe po pensionohet - tha se në mbrëmjen e sulmit dhe pas sulmit, Qeveria e Shteteve të Bashkuara u ofroi autoriteteve të Kosovës mbështetjen e forcave amerikane të zbatimit të ligjit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bëri përgjegjëse Serbinë për, siç u shpreh, "sulmin terrorist" dhe tha se ajo është duke i kopjuar metodat që aplikon Rusia në luftën e saj në Ukrainë.

Serbia i ka mohuar akuzat.

I pyetur rreth deklaratave të zyrtarëve të Kosovës se Serbia ka gisht në këtë sulm, Hovenieri përsëriti qëndrimin e tij të mëparshëm se qeveria amerikane "nuk është në gjendje të thotë se kush është përgjegjës".

Ai tregoi se zyrtarët amerikanë po punojnë me homologët e

Kosovës për të kryer "hetime efektive". "Ne besojmë se ato duhet të jenë të besueshme, të shpejta, të drejta, transparente dhe sigurisht, është pikëpamja e qeverisë amerikane që tashmë e kemi shprehur shumë fuqishëm, se përgjegjësit për këtë sulm duhet të japin llogari. Momentalisht nuk jemi në gjendje të themi se kush është përgjegjës", shtoi ai.

Kanali Ibër-Lepenci furnizon me ujë nga Liqeni i Ujmanit gjithë veriun e Kosovës, rajonet e Mitrovicës, Prishtinën me rrethinë, si dhe Korporatën Energjetike të Kosovës për ftohjen e termoelektraneve të saj.

Derisa furnizimi i KEK-ut me ujë për ftohjen e termoelektraneve të saj nuk u ndikua, shpërthimi shkaktoi shkurtime të përkohshme të ujit në disa pjesë të vendit.

Mbi 30 mijë votues nga diaspora për t'u regjistruar për zgjedhje

Prishtinë, 11 dhjetor - Nga 29 gushti kur ka filluar aplikimi për regjistrimin e votuesve nga diaspora, deri më 11 dhjetor janë bërë mbi 30 mijë aplikime, ndërsa 1 990 janë refuzuar. Në shumicën e rasteve të refuzuara, aplikuesit nuk janë fotografuar duke mbajtur njëkohësisht në dorë dokumentin e identifikimit.

Në fillim të mbledhjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është paraqitur raporti lidhur me ecurinë e zbatimit të planit të aktiviteteve për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025.

Por është duke vazhduar periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, e cila ka filluar më 29

gusht dhe do të përfundojë më 26 dhjetor 2024. "Në bazë të të dhënave, deri më 11 dhjetor, në orën 09:00, pas aplikimit përmes platformës elektronike (<http://diaspora.kqz-ks.org>) janë aprovuar 30 656 kërkesa për regjistrim, ndërsa 1 990 janë refuzuar. Në shumicën e rasteve të refuzuara, aplikuesit nuk janë fotografuar duke mbajtur njëkohësisht në dorë dokumentin e identifikimit. KQZ i informon individualisht aplikuesit e refuzuar për arsye të refuzimit të kërkesës së tyre dhe, gjithashtu, aplikuesit e refuzuar njoftohen se mund të riaplikojnë për regjistrim dhe t'i bashkëngjisin dokumentet e nevojshme për ta përmbyshur kërkesën e tyre në përputhje me udhëzimet e KQZ-së".

Gjithashtu, është duke



vazhduar periudha për ndërrimin e qendrës së votimit brenda komunës, e cila ka filluar më 29 gusht dhe do të përfundojë më 26 dhjetor 2024.

Në bazë të të dhënave, deri më 11 dhjetor 2024, në orën 09:00, janë pranuar 3 208 kërkesa për ndërrimin e Qendrës së

Votimit (2 528 përmes platformës elektronike <http://qv.kqz-ks.org> dhe 680 në zyrat e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve) prej të cilave janë aprovuar 3 090 kërkesa, ndërsa 115 të tjera janë refuzuar.

Po ashtu, është duke vazhduar edhe periudha për

kundërshtimin e pasaktësive në Listën Preliminare Votuese, e cila ka filluar më 29 gusht dhe do të përfundojë më 28 dhjetor 2024. "Gjatë kësaj periudhe çdo person me të drejtë vote që nuk figuron në Listën Votuese është caktuar gabimisht në qendër tjetër të votimit apo ka të dhëna të tjera të pasakta, përfshirë edhe rastet kur pretendon se ndonjë emër i votuesit nuk duhet të figurojë në këtë listë, qoftë edhe rastet kur figuron emri i ndonjë personi të vdekur, mund të kërkojë nga KQZ rishikimin e saj përmes sistemit elektronik apo duke u paraqitur në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në komunën përkatëse. Deri më tani nuk është pranuar ndonjë kërkesë për kundërshtim", ka njoftuar KQZ-ja.

Hovenierit i jepet Urdhri "Dr. Ibrahim Rugova"

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka dhënë ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, Urdhrin "Dr. Ibrahim Rugova".

Hovenier, i cili ka vendosur të pensionohet, do të largohet nga misioni në Kosovë këtë muaj.

Osmani e vlerësoi atë më shumë se një ambasador. "Ishte me ne kur populli i Kosovës ishte viktimë e krimeve të llahtarshme, ishte me ne kur raportonte për masakrën e Reçakut, ishte me ne kur vendosim themelet e shtetit tonë të pavarur, e ishte

me ne edhe përgjatë viteve të fundit në mbrojtje të pavarësisë, sovranitetit dhe aleancës së pathyeshme me ShBA-në", tha Osmani në një postim në Facebook, ku publikoi edhe një video nga ceremonia e ndarjes së Urdhrit.

Ky urdhër u jepet personave, vepra jetësore e të cilëve cilësohet kontribut i veçantë për ndërtimin e paqes, zhvillimin e demokracisë dhe kultivimin e humanizmit.

Hovenieri ishte në misionin e ambasadorit në Kosovë që nga fillimi i vitit 2022. "Ky çmim ka domethënie të madhe për mua, pasi përfaqëson punën

kollektive dhe përkushtimin e kujtdo që ka qenë pjesë e kësaj përpjekjeje për ta siguruar paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe për ta avancuar vizionin tonë të përbashkët për një vend sovran, demokratik dhe shumetnik. Ishte privilegj i madh të shërbej si ambasador i ShBA-së këtu në Kosovë", shkroi Hovenieri në një postim në X. Derisa ka shprehur vazhdimisht mbështetje për vendin, në disa raste edhe e ka kritikuar, sidomos qeverinë, për shkak të disa veprimeve që ShBA-ja i ka cilësuar të njëanshme dhe të pakoordinuara.





INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD) KA PUBLIKUAR RAPORTIN
MBI MOSEFIKASITETIN E HETIMIT PARLAMENTAR

Opozita akuzon qeverinë për pengim në komisionet hetimore

Hulumtuesi i lartë në IKD, Naim Jakaj, ka theksuar rëndësinë e institucioneve të hetimit parlamentar dhe të mekanizmave të kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv në një shtet demokratik. Ai ka thënë se hetimi parlamentar ka rol të jashtëzakonshëm në parandalimin e korrupsionit. Ndërkaq opozita ka theksuar se pas ardhjes në pushtet të Lëvizjes Vetëvendosje, zhvillimet e komisioneve hetimore parlamentare janë vështirësuar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Mosefikasiteti i hetimit parlamentar (Mungesë e vullnetit dhe problemet ligjore)". Hulumtuesi i lartë në IKD, Naim Jakaj, ka theksuar rëndësinë e institucioneve të hetimit parlamentar dhe të mekanizmave të kontrollit mbi pushtetin ekzekutiv në një shtet demokratik. Ai ka thënë se hetimi parlamentar ka një rol të jashtëzakonshëm në parandalimin e korrupsionit. "Shumica parlamentare dhe pozita janë pjesë përbërëse e një demokracie politike. Pra në një shtet demokratik respektimi i pluralizimit është

qenësor. Janë krijuar gjithsej 15 komisione hetimore parlamentare. Hetimi parlamentar si mjet për transparencë dhe llogaridhënie të qeverisë. Kontrolli mbi pushtetin ekzekutiv dhe parandalimi i korrupsionit. Identifikimi i dobësive dhe promovimi i reformave politike dhe administrative. Angazhimi i qytetarëve dhe ekspertëve në procesin hetimor. Sfidat në zbatimin e pasojave juridike dhe politike për shkeljet e zbuluara. Nevoja e domosdoshme për mekanizma që forcojnë përgjegjësinë ligjore dhe institucionale. Pra në kuadër të gjithë kësaj kemi vlerësuar se duhet të ndryshohet Ligji nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar", tha ai.

Një ndër problemet kryesore, Jakaj ka thënë se është detyrimi për t'i themeluar KHP-të pa votim formal në seancë plenare, ku inicimi bëhet nga 1/3 e deputetëve, një më shumë për "opozitën". Sipas tij, duhen ndjekur disa hapa si e drejta e propozuesit për ta drejtuar KHP-në, caktimi i afatit për t'i propozuar anëtarët, objekti i hetimit nuk mund të jetë çështje kontestimi, buxheti i Komisionit në Kryesi dhe jo në seancë plenare, masat/ndëshkimet financiare, dërgimi i raportit për KHP-të te Zyra Kombëtare e Auditimit dhe te Prokurori i Shtetit, konflikti i interesit gjatë ushtrimit të detyrës, pastaj monitorimi i betimit të rekomandimeve si dhe çështje të tjera teknike dhe administrative. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Driton Selmanaj, ka thënë se pas ardhjes në pushtet të Lëvizjes Vetëvendosje, zhvillimet e komisioneve hetimore parlamentare janë vështirësuar. "Përvoja ime është se ka pjesë ku kam vlerësime për punën që është bërë. Në rastin e parë kemi intervistuar edhe presidentin e

vendit. Pas ardhjes në pushtet të Vetëvendosjes kemi pasur pengesa në punën e komisioneve hetimore. Sot është një proces që po ndodh ndaj Nagip Krasniqit, ku ka pasur të gjetura. Ka pasur kompani të cilat nuk kanë pasur licencë për furnizim me energji elektrike. Nuk kanë ardhur në komision dhe kanë rrezikuar kuorumin për ta raportuar raportin. Në vend se të ndodhë e kundërta që ta kryejmë pjesën politike. Aq më shumë që kemi kaluar me kohë aq më keq ka degraduar. Kontrata njëburimore, falja e borxheve të ambalazhuesve të ujit, pengesë ka qenë Lëvizja Vetëvendosje për ta kryer komisionin hetimor", ka thënë Selmanaj. Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Shemsedin Dreshaj, ka potencuar se pozita ka dështuar të krijojë kushte të favorshme për opozitën, duke shtuar se kjo ka çuar në një situatë ku opozita është ofenduar. "Pozita që është shumicë duhet të krijojë kushte që opozita ta gjejë vendin e saj të sigurt dhe ta japë kontributin e vet, por arroganca këtë nuk po e lejon. Jemi ofenduar keq. Në këtë

mandat kemi pasur vetëm bllokim dhe uroj që të mos përsëritet më", ka potencuar Dreshaj. Drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka folur për disa aspekte kyçe rreth funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe përgjegjësisë së qeverisë për t'i plotësuar obligimet kushtetuese. "Deri në fund të mandatit nuk mund të mos themi dy anamali. Kemi qasjen e qeverisë që për herë të parë ka refuzuar të përmbushë një obligim kushtetues dhe përgjigjja e opozitës për marrëveshjet ndërkombëtare. Ne si IKD nisim me faktin që të kemi një sistem të drejtësisë së pavarur dhe është në dorën e tyre për të bërë hetim të pavarur. Partia në pushtet e ka obligimin primar që vlerat t'i ruajë, t'i mirëmbajë dhe t'i promovojë. Partia në pushtet duhet të ishte më e zëshme që këto t'i sqarojë për çdo komision hetimor dhe qytetarët e kuptojnë se çka është bërë. Për 23 vjet kemi tetë legjislatura, pra tetë qeveri dhe duhet të ndërtojmë një praktikë që Kushtetuta duhet të respektohet, nëse thërritet në komision hetimor", ka theksuar Miftaraj.



Oftamologia Qefsere Kuçi, kandidate për deputete e PDK-së

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka njoftuar se oftamologia Qefsere Kuçi do të jetë kandidate për deputete nga PDK-ja. "Kam kënaqësinë të mirëpres si kandidate për deputete

dr. Qefsere Kuçi - oftamologe e dalluar në QKUK dhe grua e jashtëzakonshme që mishëron përkushtimin, sakrificën dhe shërbimin ndaj popullit tonë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



Veliaj nderon Ali Ahmetin, ia dhuron simbolin e Kullës së Sahatit

TIRANË, 11 DHJETOR - Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka pritur në takim liderin e BDI-së, Ali Ahmeti. Në këtë takim ai e ka nderuar liderin e shqiptarëve të Maqedonisë me simbolin e Kullës së Sahatit. "Pata kënaqësinë të pres mikun tonë, Ali

Ahmetin, qytetar nderi i Tiranës, dhe t'i dhuroja simbolin e Kullës së Sahatit, në shenjë mirënjohjeje. Diskutuam mbi rëndësinë e respektimit të drejtave të shqiptarëve, si themel për paqen dhe progresin në Maqedoninë e Veriut", ka shkruar Veliaj në "Facebook".

Bislimi thotë se Serbia po tenton ta ndalë ndihmën e Kosovës për bujqit shqiptarë në Luginë

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, e ka akuzuar Serbinë se po përpiqet ta ndalë mbështetjen financiare të Qeverisë së Kosovës për bujqit shqiptarë në Luginën e Preshevës. "Qeveria e Republikës së Kosovës dënon ashpër përpjekjet e autoriteteve serbe për ta ndaluar donacionin e dedikuar për subvencionimin e bujqve shqiptarë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë", tha Bislimi në "Facebook". Më herët të martën, përfaqësues të shqiptarëve të Luginës së Preshevës thanë se Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve e Serbisë ka bërë thirrje për anulimin e një konkursi për subvencionimin e kulturave bujqësore nga një fond i Qeverisë së Kosovës. Ndonëse Qeveria e Kosovës i ndau 1 milion euro për subvencione

në sektorin e bujqësisë për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për vitin 2024, tha në tetor kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani. Bislimi tha se donacioni i Qeverisë së Kosovës synonte ta përmirësonte jetën e komunitetit shqiptar dhe ta mbështeste zhvillimin ekonomik në Luginën e Preshevës, duke ditur se "edhe më tej komuna e Preshevës, e Bujanocit dhe e Medvegjës janë ndër komunat më të pazhvilluara në Serbi, ndër më të varftrat me papunësi të lartë e veçanërisht të rinjtë". Këshilli Kombëtar Shqiptar kishhte shpallur thirrjen publike për bujqit më 26 tetor 2024 dhe prej atëherë i ka pranuar mbi 1 178 aplikime, sipas Bislimit. "Pikërisht më 10 dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, shqiptarëve në



Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë u është mbivendosur privimi nga mundësia e ndihmës nga Republika e Kosovës", tha Bislimi. Ai tha se Serbia nuk ka asnjë të drejtë ta pengojë mbështetjen e Kosovës për shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare të reagojë dhe "të veprojë për t'i mbrojtur të

drejtat e shqiptarëve në Luginën e Preshevës". Të martën në mëngjes, kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar (KKSH) në Luginën e Preshevës, Nevzad Lutfiu, tha se Ministria serbe i ka kërkuar KKSh-së ta anulojë konkursin. "Ministria në fjalë kërkon që konkursi të anulohet (të shfuqizohet vendimi i KKSh-së), nëse ne nuk e shfuqizojmë këtë vendim atëherë atë do ta bëjë vetë ministria, me pretekstin se vendimi është i jashtëligjshëm, thuhet në kundërpërgjigjen e Ministrisë", shkroi ai në "Facebook". Luftiu nguli këmbë se Këshilli nuk do ta shfuqizojë konkursin, duke shtuar se "pas konsultimit me Qeverinë e Kosovës, do të njoftoheni me hapat e mëtejshëm". Sinani tha se ajo si kryetare e Preshevës e dënon "fuqishëm këtë veprim diskriminues" dhe shprehu mbështetjen e saj për

KKSh-në dhe të gjitha institucionet shqiptare "që punojnë për t'i mbrojtur interesat e popullatës sonë". Shqiptarët që jetojnë në komunat në jug të Serbisë, Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc - që njihen me termin Luginë e Preshevës - shpesh ankohen për praktika diskriminuese nga shteti serb, teksa zyrtarët në Qeverinë e Kosovës u kanë bërë jehonë këtyre akuzave. Shqiptarët në Luginë të Preshevës për vite të tëra ankohen edhe për pasivizim të adresave të banimit dhe gjatë këtij viti kanë protestuar disa herë duke kërkuar më shumë të drejta. Banorët e Luginës dhe udhëheqës të komunave atje kanë kërkuar disa herë që të ketë prani të mekanizmave ndërkombëtarë në mënyrë që të monitorohen kushtet e jetesës në atë pjesë.

APK-ja paralajmëron se së shpejti do ta lansohet sistemi ku do të raportohen rastet e konfliktit të interesit

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Në Kosovë po shënohet Java Kundër Korrupsionit, ndërsa nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) kanë deklaruar të mërkurën se është shënuar përparim në luftimin e konfliktit të interesit. Ndonëse në tryezën me temën "Parandalimi i konfliktit të interesit, parakusht për besim në institucione", organizuar

nga APK-ja, u theksua se ka ende raste në rritje. Yll Buleshkaj, drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ka thënë se kjo agjenci ka shënuar përparime në luftimin e konfliktit të interesit, mirëpo nuk ka mohuar as sfidat në luftimin e kësaj dukurie. "Së shpejti do ta lansojnë sistemin ku do të mund të raportohen në mënyrë elektronike shkeljet e

ndryshme, përfshirë edhe ato të konfliktit të interesit. Kemi përparime, por rastet po rriten. Se pse po rriten, a është ky rezultat që ka më shumë konflikt interesi apo ndoshta është një rezultat që qytetarët dhe zyrtarët publikë janë vetëdijuesur më shumë se çka është konflikti i interesit dhe tashmë raportojnë më shumë këto raste, ne po besojmë që është e dyta", tha ai.



Inicohet marrëveshja për sigurime shoqërore me Slloveninë

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka pritur në takim zëvendës-kryeministrin, njëkohësisht ministrin e Punës, Familjes, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta të Sllovenisë, Luka Mesec. Gjatë takimit palët u pajtuan të iniciohet marrëveshja për sigurime shoqërore në të mes dy vendeve në mënyrë që të lehtësohet barra e qytetarëve

tanë që jetojnë në Slloveni si dhe anasjelltas, duke u mundësuar atyre ta realizojnë të drejtën për pension në vendin ku jetojnë. "Inicimi i kësaj marrëveshjeje u konsiderua si interes i përbashkët i të dyja vendeve, andaj takimi i sotëm hapi rrugë për fillimin e negociatave ndërmjet ekepeve teknike drejt finalizimit të marrëveshjes. Më tutje në këtë takim u diskutuan edhe

mundësi të tjera për bashkëpunim ndërmjet dy vendeve, me theks të veçantë tek fusha e punësimit dhe mundësia e zhvillimit të programeve të përbashkëta në këtë drejtim. Palët shprehën vullnetin e tyre për të thelluar bashkëpunimin mes dy shteteve përmes nismave konkrete në dobi të qytetarëve të të dyja vendeve", ka njoftuar Ministria e Financave.



Universiteti i Prishtinës, një vend ku promovohen të drejtat e njeriut

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut u shënuar në Fakultetin Juridik me një bashkëbisedim të avokatit të popullit, Naim Qelaj, me studentë, përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile. Pjesë e bashkëbisedimit, përveç Qelajt, ishin edhe rektori i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu dhe aktivistja e të drejtave të njeriut, Igballe Rogova, ndërsa takimi u hap dhe u drejtua nga prodekani për çështje mësimore dhe të cilësisë në Fakultetin Juridik, Florent Muçaj. Teksa foli për rolin e Universitetit të Prishtinës për edukimin në lidhje me të drejtat e njeriut dhe

promovimin e këtyre të drejtave, rektori Arben Hajrullahu theksoi rolin kyç që ka universiteti për promovimin e kulturës së të drejtave njerëzore. Ai porositi studentët që, për të mos shkelur të drejtat e njeriut, të nisen nga parimi ynë kulturor: "Atë çfarë nuk ia dëshiron vetes, mos ia bëj tjetrit". Avokati i popullit, Naim Qelaj, në ditën më të rëndësishme për institucionin që e drejton, tregoi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Tha se duke pasur parasysh të kaluarën e rëndë e diskriminuese nëpër të cilën kaloi më herët populli i Kosovës, ka progres të jashtëzakonshëm në avancimin e të drejtave të



njeriut. Ai deklaroi se pavarësisht që konstatohet se Kosova ka ligje të mira, ato duhet të përmirësohen dhe të zbatohen

plotësisht. Aktivistja e të drejtave të njeriut dhe Rrjetit të Grave të Kosovës, Igballe Rogova, tha se ligjet na japin një jetë më të mirë, jo

vetëm miratimi i tyre, por edhe zbatimi. Rogova u tha studentëve të pranishëm se "nuk po ju drejtohem si e ardhmja", por i quajti ata e tashmja e Kosovës. Pastaj bashkëbisedimi vazhdoi me pyetje-përgjigje mes të pranishmëve dhe panelistëve. Për aktivitete të përbashkëta në mes të Universitetit të Prishtinës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit u pajtuan drejtuesit e këtyre dy institucioneve, Arben Hajrullahu dhe Naim Qelaj, në një takim që patën më 27 nëntor. Më 10 dhjetor 2024 u mbushën plot 76 vjet nga miratimi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Nënshkruhet marrëveshje për zgjidhjen e problemit me ujë të pijshëm në gjashtë lokalitete të Kamenicës

KAMENICË, 11 DHJETOR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka nënshkruar marrëveshje me kryeshefin e KRU Hidromorava, Ymer Salihu. Kjo marrëveshje përfshin menaxhimin e rrjeteve të ujesjellësit në gjashtë lokalitete si Roganë, Hodonoc, Muçiverc, Shipashnicë, Novosellë dhe Dajkoc, lokalitete këto me 1 710 familje. Kryetari Rahimaj theksoi se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje po rritet kapaciteti i ujit në 100 për qind në krahasim me



periudhën sa ka qenë. "Deri më tani është bërë një punë maratonë me një përkrahje tejet të madhe duke i

bashkuar forcat me KRU Hidromorava dhe me mbështetjen e ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe zëvendësministrit Getoar Mjeko, për të finalizuar një nga projektet më jetike për qytetarët tanë në këto fshatra", ka thënë Rahimaj. I pari i komunës theksoi se fillimi i kësaj marrëveshjeje do të jetë testimi dhe pranimi teknik, më pas në një kohë të shkurtër të gjitha këto familje do të kenë ujë në shtëpitë e tyre. Në anën tjetër kryeshefi i

KRU Hidromorava, Ymer Salihu, falënderoi kryetarin Rahimaj për bashkëpunimin, dhe tha se në këtë fushë kanë punuar ekspertë të shumtë. "Ne së bashku me ju do të formojmë një komision dhe do t'i gjejmë defektet se ku janë, dhe brenda një periudhe shumë të shkurtër do të kenë ujë të bollshëm", është shprehur Salihu. Në këtë takim morën pjesë edhe drejtori i DShPAIE, Zotrim Kastrati, zyrtarja e lartë e financave në KRU Hidromorava, Merita Xhelili dhe përfaqësuesit e fshatrave.

Për shkak të sfidave të rrezikshme, deputetët kërkojnë mbylljen e "Tik-Tok"-ut

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Në mbledhjen e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes është diskutuar mundësia e mbylljes së platformës "Tik-Tok" shkaku i rasteve të fundit të sfidave të rrezikshme. Komisionarja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dërmaku, ka thënë se prioriteti i agjencisë është mbrojtja e të dhënave personale. "Forcimi i

transparencës dhe llogaridhënies dhe zbatimi i programit të transparencës për publikimin proaktiv të informatave dhe dokumenteve nga institucionet publike dhe shqyrtimin e ankesave, zhvillimi i Programit të transparencës së Institucioneve Publike që siguron të dhënat e hapura dhe publikimi proaktiv i dokumenteve publike, realizimi i së drejtës për qasje në

dokumente publike përmes shqyrtimit të ankesave të pranuar nga subjektet dhe monitorimin e institucioneve publike në zbatimin e ligjit", u shpreh Sogojeva-Dërmaku. Ajo u pyet nga deputetët edhe për mbylljen e rrjetit social "Tik-Tok", por shtoi se kjo është politikë qeveritare. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Dimal Basha, e pyeti kryetaren e AIP-së lidhur

me mundësinë që të mbyllet rrjetet sociale, konkretisht "TikTok"-u. Rrezikun nga rrjeti social "TikTok" e përmendi edhe deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Hisen Berisha. "Nëse ShBA-ja ndihet e rrezikuar nga kjo platformë, atëherë ku e ka fuqinë Kosova dhe sa jemi të pajisur nga këto vërshime të këtyre aplikacioneve që konsiderohen të dëmshme dhe



a kemi ndonjë kampanjë ndërgjegjësimi për qytetarë për përdorimin e këtyre aplikacioneve", u shpreh Berisha. (kp)

SBASHK-u i reagon Muratit: A ke edhe ndonjë sulm kundër punëtorëve të arsimit?

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), përmes një reagimi publik, ka kritikuar ministrin e Financave, Hekuran Murati. Në reagim thuhet se ministri nuk ka mbështetur nismën qytetare të nënshkruar nga mbi 20 mijë qytetarë, e që u kërkohet t'u kthehet e drejta e punëtorëve të arsimit për vitet 90 si kontributdhënës. "Një mendim juridik, pa as edhe një argument të qëndrueshëm i datës 11 nëntor, doli nga Ministria që drejtoni ju ministër Murati dhe e gjete rastin pikërisht një ditë para Festës së madhe të Flamurit Kombëtar ta prezantoni në takim të Qeverisë dhe nuk e mbështetët nismën qytetare nënshkruar nga 20.606

qytetarë, e që kërkonte t'u kthehej e drejta e fituar punëtorëve të arsimit për vitet e '90-ta si kontributdhënës", thuhet në reagimin e SBASHK-ut. Ndër të tjera, SBASHK-u thekson se kjo nismë, pavarësisht qëndrimit kundër të qeverisë, do ta vazhdojë rrugëtimin dhe se shpreson shumë se deputetët do ta votojnë. "Ministër Murati, ky nuk është sulmi i vetëm nga ti, kundër punëtorëve arsimorë. Mendimi juridik lidhur me këtë çështje që ka disa faqe tekst pa as edhe një argument, nuk e thotë të vërtetën e çështjes, e që e lexuam disa herë me kujdes. Aty përmendet edhe Kushtetuesja, por ajo me fjalën 'diskriminim' nuk ju ka autorizuar t'ua mohoni këtë të drejtë të garantuar me Ligj punëtorëve të arsimit të viteve

të '90-ta, por që këtë të drejtë t'ua pranoni edhe gjithë punëtorëve të dëbuar dhunshëm nga puna nga institucionet e instaluar represive serbe në ato vite. Sipas jush, ata që i shërbyen pushtuesit shpërblehen edhe tani me pensione të plota e ata që bënë sakrificat sublimë për shtetësinë e Kosovës ndëshkohen edhe tani me pensione", vijon reagimi. Më tutje, SBASHK-u shton se "ministër Murati, nuk besoj se as edhe një shqiptar i Kosovës, pavarësisht bindjes politike, pajtohet me këtë realitet të tmerrshëm sepse nga populli ynë punëtorët e arsimit në vitet e '90-ta janë konsideruar heronj të kohës". Gjithashtu, SBASHK-u ka bërë edhe disa vlerësime për punën e ministrit Murati. "Ministër

Murati, tani kur po përfundoni këtë mandat, ne po bëjmë një vlerësim me fakte të qëndrimit të Qeverisë suaj dhe të Qeverive të tjera të Republikës së Kosovës ndaj punëtorëve të arsimit, por edhe ndaj policisë, zjarrfikësve, punëtorëve shëndetësor, të administratës dhe gjithë të punësuarve në sektorin publik. Qeveritë tjera të Republikës së Kosovës zhvilluan dialog dhe në takime u munduan të ofrojnë zgjidhje, bile për ndonjëherë kërkesë. Ju nuk zhvilluat as takime e as dialog". Në reagimin e SBASHK-ut, po ashtu, përmendet edhe puna e qeverive të tjera. "Tani po të kujtojmë se çfarë kanë bërë Qeveritë e tjera të Republikës së Kosovës për arsimin dhe do të përmend vetëm nga një veprim të tyre. Kryeministri Hashim Thaçi dhe

Qeveria që drejtonte, ai nuk i iku kurrë dialogut me sindikatën dhe duke respektuar kërkesën tonë bëri ngritje të vazhdueshme e të dukshme të pagave. Kryeministri Isa Mustafa tregoi mirëkuptim ndaj kërkesës sonë dhe falë angazhimit të ish zv/kryeministrit Kujtim Shala dhe ministrit Arban Abrashi e kthyen në realitet pikën 6 të nenit 8 të Ligjit për skemat pensionale dhe punëtorët e arsimit gëzonin pension të punës e jo të pleqërisë. Kryeministri Ramush Haradinaj tregoi mirëkuptim ndaj kërkesës sonë dhe duke shprehur respekt për sakrificat sublimë të punëtorëve të arsimit në vitet '90-ta bëri Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet '90-ta, Ligj ky që në shenjë respekti për ato vite u siguron një shtesë materiale të pensionuarave e që punuan me në ato vite me sistemin arsimor të Republikës së Kosovës", thuhet në reagimin e SBASHK-ut.

Më tej, po në komunikatë, thuhet se kryeministri Avdullah Hoti ishte vazhdimisht pranë punëtorëve të arsimit edhe kur po përballeshim me një armik tepër të rrezikshëm, pra me Covidin, mbështeti punëtorët arsimorë me një shtesë prej 100 eurosh dhe u angazhua bashkë me ministrin Ramë Likaj për nënshkrimin e Kontratës së re të Arsimit të Kosovës. SBASHK-u shton se riktheu kujtesën dhe përmend vetëm një veprim pozitiv të atyre qeverive të Republikës së Kosovës, se angazhime e veprime të tilla kishte edhe më shumë. "Ministër Murati, për Qeverinë tuaj nuk gjetëm as edhe një veprim dhe as një rast që jeni takuar me sindikatën tonë dhe keni ofruar zgjidhje në kërkesat tona legjitime. Ju, në vend të kësaj, gjatë gjithë këtyre katër viteve keni vazhduar të keni qasje të gabuar e madje edhe armiqësore ndaj sindikatës sonë dhe ua keni mohuar edhe të drejtat e fituara punëtorëve të arsimit", theksohet në reagimin e SBASHK-ut.

Parandalimi i aksidenteve rrugore, policia ndërmerr një sërë masash dhe aktiviteteve


PRISHTINË, 11 DHJETOR - Policia në rajonin e Mitrovicës së Veriut, me qëllim të garantimit të sigurisë dhe parandalimit të aksidenteve rrugore, ka ndërmarrë një sërë masash dhe aktiviteteve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve po shpërndahen fletushka informuese për drejtuesit e automjeteve dhe

pjesëmarrësit e tjerë në trafik, të cilat përmbajnë këshilla dhe udhëzime për ngasje të sigurt në kushte dimri. "Synimi kryesor është ndërgjegjësimi i drejtuesve të automjeteve për rëndësinë e kujdesit të shtuar gjatë ngasjes në rrugë të mbuluara me borë dhe ngrica, për t'i minimizuar rreziqet dhe aksidentet e mundshme", ka

njoftuar policia. Policia e Kosovës apelon te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që t'u përmbahen rregullave të përcaktuara në Ligjin për Sigurinë në Trafik Rrugor, duke treguar kujdes të veçantë në këto kushte atmosferike. Bashkëpunimi i të gjithëve është i domosdoshëm për një ambient të sigurt rrugor.



Qindra miliona euro për investime kapitale mbeten në portofol



PRISHTINË, 11 DHJETOR - Rruga Komoran - Drenas - Skenderaj, një qendër e mjekësisë familjare në Drenas, një çerdhe në komunën e Malishevës, një fushë sporti po në këtë komunë, janë vetëm disa nga dhjetëra projektet kapitale të planifikuara për këtë vit, por që nuk u realizuan.

Se përse ndodhi kështu, zyrtarët komunalë në Drenas e Malishevë nuk iu përgjigjën "Radios Evropa e Lirë".

Paratë për projekte kapitale në Kosovë planifikohen me buxhetin e çdo viti kalendarik.

Më buxhetin e përgjithshëm të këtij viti prej 3.3 miliardë eurosh, për investime kapitale ishin ndarë 859 milionë euro.

Prej tyre, deri në tetor, u shpenzuan rreth 215 milionë euro, sipas raporteve të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), ndërsa në portofol mbeten edhe rreth 644 milionë.

Projektet në të cilat u investua këtë vit, por edhe viteve të kaluara, përfshijnë kryesisht: ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale, blerjen e pajisjeve informative, kompjuterëve dhe automjeteve transportuese, renovimin e institucioneve publike, si: çerdhe, objekte spitalore, shkolla e të tjera.

Në katër vjetët e kaluar, nën qeverisjen e kryeministrit Albin Kurti nga Lëvizja Vetëvendosje, u ndanë gjithsej mbi 3 miliardë

euro për projekte kapitale. Prej tyre u shpenzuan vetëm 1.6 miliard.

MFPT-ja nuk iu përgjigj pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" se cila është arsyeja e mosshpenzimit të këtyre parave. Një gjë e tillë nxiti kritika të ashpra nga opozita, e cila e konsideroi si tregues dobësie të Qeverisë Kurti.

Kjo, pavarësisht faktit se mjetet e ndara për shpenzime kapitale nuk u shpenzuan as në qeverisjet paraprake, të udhëhequra nga kryeministri Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Avdullah Hoti i Lidhjes Demokratike të Kosovës - tani në opozitë.

Në vitin 2017, për shembull, kur Haradinaj qeveriste në koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës, Nismën, Aleancën Kosova e Re, Listën Serbe dhe pakicat joserbe, u ndanë mbi 720 milionë euro për shpenzime kapitale, por u shpenzuan mbi 460 milionë.

Në çdo vit, nga 2017-ta e kënde, tepruan qindra miliona euro.

Instituti për Studime të Avancuara, GAP, publikoi më 19 nëntor raportin "Projektbuxheti 2025 - Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve", ku thuhet se efikasiteti në mbylljen e investimeve nga viti 2016 deri më 2023, ishte i ulët.

Në raport theksohet se "numri i projekteve të bartura nga viti në vit vazhdon të jetë i lartë" dhe se

me ndërrimin e qeverive "ndërrohen edhe prioritetet e projekteve".

Pa saktësuar se cilat janë, raporti përmend 264 projekte kapitale, që u planifikuan gjatë periudhës 2008-2019, e që nuk përfunduan dhe u bartën në buxhetin e vitit 2025, me një shumë prej 258 milionë eurosh të ndarë për to. GAP-i, i cili monitoron punën e institucioneve të Kosovës, publikoi edhe në dhjetor të vitit të kaluar një raport, ku u tha se me buxhetin e vitit 2023, dhjetëra miliona euro u ndanë për projekte të filluara vite më parë. Për shembull, mbi 22 milionë euro u ndanë për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, që nisi në mars të vitit 2010, ndërsa 20 milionë u ndanë për rehabilitimin e linjës hekurudhore Fushë-Kosovë-Han i Elezit - projekt ky i nisur qysh në vitin 2016.

Çka thotë opozita?

Përfaqësues të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në opozitë thonë se Qeveria aktuale ishte "më e dobëta" në realizimin e projekteve kapitale.

Ata i arsyetojnë qeverisjet e mëparshme, duke thënë se në kohën e tyre kanë nisur projektet. "Ka shumë projekte që

kjo qeveri i ka gjetur në proces dhe nuk janë afër përfundimit", thotë për "Radios Evropa e Lirë" Arben Mustafa nga PDK-ja.

Në mesin e tyre, ai përmend autostradën Prishtinë-Gjilan, e njëjtë thotë se janë edhe rrugët Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Podujevë, stadiumi i Gjilanit e të tjera. "Pra, nuk ka progres dhe nuk është arritur të sigurohet një vijueshmëri e këtyre projekteve", sipas tij.

Për Pal Lekajn nga AAK-ja, Qeveria e tanishme ka dështuar edhe "në infrastrukturë shkollore e shëndetësore".

Kërkesës së "Radios Evropa e Lirë" për koment nuk iu përgjigj Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila me kryeministrin Avdullah Hoti qeverisi në koalicion me disa parti të tjera nga qershori i vitit 2020 deri në mars të vitit 2021. Ngjashëm nuk u përgjigjën as nga Lëvizja Vetëvendosje, e cila mban pushtetin aktual.

Çka thonë ekspertët?

Prej vitesh, Zyra Kombëtare e Auditimit identifikon planifikimin e dobët, mungesën e kapaciteteve zbatuese, vonesat në procedurat e prokurimit si arsye të mosrealizimit të projekteve kapitale.

Sipas Blendit Hasajt, drejtor ekzekutiv në Institutin GAP, një arsye tjetër është edhe përfshirja

e ministrive jokompetente, siç thotë ai, në investime kapitale.

Ai sugjeron që investimet kapitale t'i menaxhojë vetëm një ministri, si ajo e Infrastrukturës, për shkak të ekspertizës dhe ekipit më të përgatitur, ndërsa ministrinë e tjera të fokusohen në reformat përkatëse.

"... sepse, për shkak të mungesës së specializimit, ministrinë që nuk e kanë prioritet drejtimin e infrastrukturës, çalojnë në arritjen e afateve, në përgatitjen e planeve të prokurimeve me kohë. E gjithë kjo pastaj, në formë zinxhimore, ndikon edhe në realizimin e investimeve kapitale", thotë Hasaj.

Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit, thotë se nënshpenzimi për projekte të premtuara në infrastrukturë, bujqësi, shëndetësi, arsim e fusha të tjera tregon për mungesë të seriozitetit dhe përgjegjësisë nga ana e ekzekutivit - kushdo që e udhëheq atë.

Më shumë se në politikë, moszbatimi i këtyre projekteve ndikon në jetën e qytetarëve dhe zhvillimin afatgjatë të vendit, sipas tij. "Bizneset e mëdha që përgatiten për të realizuar projekte kapitale, kanë makineri, kanë teknologji, sigurojnë punëtorë. Mosrealizimi i tyre i dëmton, sepse nuk kanë të hyra në biznese për t'i mbuluar shpenzimet, ndaj e zvogëlojnë numrin e punëtorëve e, rrjedhimisht, bie edhe konsumi", thotë Shahini, duke sugjeruar që atyre t'u jepet më shumë përparësi.

Në projektbuxhetin e vitit 2025, i cili ka vlerën e 3.6 miliardë eurove dhe kaloi shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Kosovës, rreth 930 milionë euro parashihen për projekte kapitale. Nëse përcillet trendi i viteve të fundit, gjasat janë që edhe vitin e ardhshëm të teprojnë qindra miliona euro.

Për ekspertët, kjo është paradoksale derisa vendi përballet me një normë të papunësisë mbi 10 për qind, paga mesatare është 570 euro dhe parashikimi për rritje ekonomike sillet nën 4 për qind. "Ka qytetarë që e kanë cilësinë e jetesës jo në nivel të duhur, sepse në zonat ku disa jetojnë, nuk ka rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit. E kjo ndikon në kualitetin e jetesës", përfundon Hasaj.

Kostoja e ndërtimit në Kosovë u rrit për 0.9 %

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e tretë (TM3) 2024.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0.9 % në TM3 2024, krahasuar me TM2 2024.

Ndërkaq, krahasuar TM3 2024 me të njëjtën

periudhë të vitit paraprak TM3 2023, Indeksi i Kostos së Ndërtimit pati rritje për 4.5 %.

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për (0.9 %) në tremujorin e tretë (TM-3) 2024 krahasuar me tremujorin e dytë (TM-2) 2024. Rritje kishte te energjia (20.1 %), pagat (1.3 %), materialet (0.7 %), makineritë (0.4 %)

dhe kostot e tjera (0.2 %).

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje (4.5 %) në tremujorin e tretë (TM-3) 2024 krahasuar me tremujorin e dytë (TM3) 2023.

Rritje më të madhe kishte te energjia (26.6 %), pagat (17.4 %), transporti (8.3 %), materialet (2 %), kostot e tjera (1.3 %) dhe makineritë (1.2 %).



TË REJA NGA KOSOVASTANI



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Lotët e "krokodilit" Kurti: Në Burgun Politik të Hagës, si pengje në një proces të montuar politik po mbahen presidenti Hashim Thaçi, kryetarët e Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli si dhe shefi i GP të LV-së, Rexhep Selimi. Më herët, me dënime drakonike ishin dënuar ushtarët shembullorë të UÇK-së, Nasim Haradinaj, Hysni Gucati dhe Salih Mustafa. Së fundi, gjithashtu me dënim drakonik u dënuar Pjetër Shala, ushtar i vendosur dhe i devotshëm i UÇK-së. Janë arrestuar, bastisur, maltretuar dhe dhunuar shumë pjesëmarrës të UÇK-së, familjarë të tyre, madje edhe anëtarë të ekipit mbrojtës që nuk ka ndodhur në asnjë proces të ngjashëm më parë. Të ashtuquajtura Dhoma të Specializuara në koordinim të plotë me të ashtuquajturën Zyra e Prokurorit të Specializuar, sikur të ishin një trup kanë bërë, po bëjnë edhe të pamundurën të sigurojnë dëshmitarë të rremë, të mbrojtur dhe publikë në Serbi dhe Kosovë, serbë, romë dhe shqipfolës, ushtarë, oficerë, prokurorë, gjykatës, gazetarë, "aktivistë" për të drejtat e njeriut, UDB-ash, anëtarë të partive politike dhe profile tjera për të sajuar tregime dhe dëshmi për t'i dënuar pengjet e Hagës. Personeli përndjekës juridikë i Hagës janë një tufë e hijenave lëvizëse që përcjellin luftërat në botë nga, në emër të "drejtësisë" nxjerrin shumë përfitime politike dhe materiale. Hijena të pangopura! Të njëjtit punuan në Kosovë gjatë UNMIK-ut, EULESH-it, punuan edhe për Tribunalin e Hagës dhe nuk gjetën prova fajësuese, ndërsa tani kur biznesi i kontrabandimit të drejtësisë ishte duke falimentuar, angazhuan dhe i besuan një raportin për trafikim të organeve njerëzore, një rusi, Kosaçev dhe një serbo-zvicerani Dick Marty pas së


cilave filloi Përndjekja e Madhe kundër UÇK-së, udhëheqësve më të lartë politikë dhe ushtarakë, kundër historisë kombëtare dhe vlerave të shenjta kombëtare. Si kolaboracionistë të besueshëm ishin edhe bartës të posteve të larta të pushtetit aktual, qoftë duke dërguar materiale "dëshmuese", qoftë duke siguruar dëshmitarë të mbrojtur, qoftë duke i sulmuar publikisht si "shkatërrues të shtetit", qoftë duke ua pakësuar fondet për mbrojtje apo duke i diferencuar gjatë vizitave, në baza politike dhe partiake. Më vonë, kur të bëhen publike disa letërkëmbime të pushtetit aktual me inkuizitorët e Hagës, do të bëhet e qartë, edhe pse janë burgosur, pse po gjykohen dhe pse janë dënuar. Presidentja Vojsa Osmani kurrë nuk i ka vizituar, i ka përmendur vetëm kur ka vlerësuar se do të përfitojë politikisht dhe materialisht ndonëse nuk ka lënë vend pa vizituar në botë. E patë që në Katedralen e rinovuar Notre Dam në Paris, i përcjell çdo hap nga Quasimodo (Llaskuci i Parë), vetëm sa nuk i theu këmbët duke ndjekur Trampin, Muskun, zonjën Macron dhe të tjerët për një shtrëngim duarsh dhe një foto për album familjar! Më thoni çfarë dobie politike apo tjetër i solli vendit kjo maratonë e përndjekjes që ua bëri presidentja figurave vendimmarrëse brenda hapësirës së Notre Damit?! Lexuesi i deklaratës glorifikuese për personalitetin e kandidatit për KM të LV-së, e njohur si amebë politike dhe njerëzore ishte njëherë në vizitë në Hagë duke përdorur, të bastarduar formulën e Cezarit, veni, vidi, vic dhe ju rrejta. Premtoi formimin e një mekanizmi që do të kërkonte transparencë dhe llogaridhënie nga kjo monstër parajuridike dhe aty nisi dhe aty përfundoi rrena e tij. Një figurë që vetëm anatomia e pranon si njeri, pa vlera njerëzore, morale, pa një të kaluar kombëtare dhe politike, rrenc, intrigant, mashtrues dhe dezertues nga çdo vlerë njerëzore e vizitoi vetëm Rexhep Selimin, të tjerët nuk ekzistonin për këtë krijesë anatomike. Rezultatet e prekshme dhe konkrete

ishin vetëm pasi një pjesë e tyre u vizituan nga Ministria e Drejtësisë; iu shkurtuan fondet për mbrojtje, u shkëputën kontratat me mbrojtës sikur që nuk u la rast pa u sulmuar, nënçmuar dhe fyer. Albin Kurti ishte më korrekti dhe më konkreti, asnjëherë nuk i vizitoi, as emrat nuk ua përmendi hiç këtu të Rexhep Selimit të cilin e respekton aq sa unë e respektojë gjyshen e Aleksandër Vulinit. Pjesa më e madhe e LV-së që e kanë ADN-në politike jugosllave dhe serbe janë të lehtësuar dhe gëzuar që Rexha është në Hagë e jo në LV. Dy muaj para zgjedhjeve parlamentare KM Kurtit iu kujtua se në Hagë, përveç Rexhep Selimit, janë edhe Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli të cilët deri dje nuk kishin emër. Madje tha se ata padrejtësisht po mbahen në Hagë sikur që e lëshoi një pordhë tekonike duke thënë se mbrojtja e tyre nuk duhet të jetë juridike por politike, argument që fyen edhe inteligjencën e Mefit, Dimalit dhe Halil Thaçit të njohur kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht si ajka e mendimit politik dhe intelektual shqiptar! Lotët e vonuar të "krokodilit" Kurti janë vetëm për vota dhe asgjë tjetër të cilave nuk iu beson askush, më së paku derdhësi i tyre, Albin Kurti.

Rezultatet e zgjedhjeve të ardhshme, të pritshme dhe "befasuese": Thuaja para një viti në një shkrim për gazetën "Epoka e re" kam shkruar se LV nuk ka gjasa të fitojë 50 + 1% dhe se opozita do të rritet varësisht nga opozitarizmi që do ta bëjë. LV-ja që nënkupton se është Albin Kurti pati mundësinë dhe rastin e artë të bëjë punë të mira për Kosovën dhe qytetarët e saj aq më parë që opozita ishte në vdekje klinike, një pjesë e shoqërisë civile u korruptua nga pushteti duke u shndërruar në lëvyrës dhe jargavitës të neveritshëm. Pushteti i madh, numri i madh i votave i shndërroi pushtetarët dhe lakejtë qyrravec të tyre në hijena të veshura me lëkurë qengji. Në shkrimin e parë, pas fitores plebishitare të Albin Kurtit kam shkruar se Albini ose do të bëhet Hasan Prishtina ose Rrahman Morina. Hasan Prishtinën e përzënë nga Prishtina,

Rrahman Morinën e ngjallën politikisht Veton Surroi dhe Welleri duke ia servuar Albin Kurtit Marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit, të cilën jam i sigurt se nuk do ta pranonte as Rrahman Morina, aq e dëmshme është për Kosovën. Për më keq, KM Kurti shpërbleu projugosllavin e thekur, Veton Surroin duke i siguruar një vend pune te Naimi për një pagë mizerie vetëm 3 500 në muaj, shpenzime xhepi. Edhe vajzën ia rehatoi në zyrën e KM sikur që i degdisi anekënd botës anëtarët e tjerë të familjes në ambasada, konsullata, borde, ministri, etj. Wellerit ia mbushi gushën në euro sikur që edhe gruan ia vendosi ku ajo deshti dhe ku ka mundësi të dëmtojë edhe më shumë Kosovën. Nipat politikë të Arkanit i bëri përgjegjës të arsimit sikur që e bëri edhe hajnin e qindra mijëra eurove të Bacë Adem Demaçit. E afirmoi, fuqizoi dhe institucionalizoi mendësinë jugosllave dhe proserbe në Kosovë, përçau shqiptarët në Luginë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, diasporë dhe në Kosovë e instaloi fjalorin toksik si vlerë morale, kombëtare, njerëzore, politike dhe intelektuale. E mbyti frymën kombëtare në LV-së duke i shndërruar ish-patriotët në bartës të xhirollogarive ku derdheshin mjete të mjaftueshme për amortizim të patriotizmit. Deri vonë manipuloi me një pjesë të familjes Jashari dhe këtë manipulim e ndërpreu vetëm ZdraVVo Mimoza me zemlakët e saj. Po ku ka poshtërsi më të madhe se të merresh vesh me Radoiçiqin kundër veteranëve të luftës e pastaj të përkulesh dhe përqyrrësh para Panteonit të Lavdisë së Përrjetshme të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe ta vizitosh pastaj Kullën e Jasharajve?! Kjo më nuk dhezë të votuesit e as manipulimi i paskrupullt me fatkeqësinë e Arbnor dhe Astrit Deharit, që nuk bënë asgjë për t'i zgjidhur këto raste dhe bënë çdo gjë për të penguar zbardhjen e tyre! Albin Kurti erdhi në pushtet se do ta luftojë korrupsionin e qeverive të kaluara ndërsa korrupsionin e bëri mënyrë të qeverisjes kurse nepotizmin e shndërroi në konkurs ku të vetmet kualifikime që kërkoheshin ishin përkatësia politike dhe ajo familjare që

ndërlidhej me partiaken. Askush nuk i ka nëpërkëmbur vlerat e luftës se pushteti aktual. Kurrë në Kosovë nuk janë qenë më të helmuara raportet midis subjekteve politike dhe qytetarëve se që janë tani. Dhe shumë të tjera për të cilat do të shkruaj më vonë. Ndjehem shumë keq për Albinin që ja rënë në këtë gjendje për faktin se e kam përkrahur shumë që nga fillimi, politikisht, me shkrime, me logjistikë dhe mjete materiale për çka kam dëshmi. Më lart thashë se LV-së është vet Albini dhe pa Albinin shndërrohet në mbetje mortore politike. Rënia e Albinit, për fajin e tij e jo të tjerëve pashmangshëm e rrënon edhe VV-në. Para tre muajve i kam dhënë LV-së 33 për qind të votave, para dy jave 30 për qind. Tash i japë më pak se 30 për qind. LDK-ja dhe PDK-ja rriten sikur që AAK do të rritet, pa asnjë dyshim. La mundësi të mëdha që edhe Lista për Familjen ta kalojë pragun. Të gjitha këto rritje e shembin LV-në për 20 deri në 25 për qind nuk kanë ku t'i marrin votat tjetërkund. Me një siguri të madhe, nëse nuk ndodhë diçka e paparashikueshme, as Albin Kurti nuk do të jetë më KM, e as LV-ja në qeveri. Por, nëse ndodhë që LV-ja të përsëritë fitoren dhe të ndërtojë institucionet e vetme, me kondomët politik, Guxo dhe Alternativa, autoritarizmi diktatorial që e zbaton Albini në pushtet dhe që ka bërë përpjekje ta zbatojë edhe tek opozita, mediet dhe te pjesa e pabindur dhe e panështruar e shoqërisë civile do të krijojë kushtet që kryeministër të ardhshëm të Kosovës ta kemi, jo Albin Kurtin, por Albin el-Assadin. Po i presë listat përfundimtare për Kuvend të Kosovës, pas së cilave do ta kemi një qartësim më të madh të situatës. Deri atëherë do të marrim frymë aq sa na lejohet kurse Instituti Kombëtar i Shëndetësisë le të bëhet gati ta bëjë dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e Kuvendit të Kosovës. Është më se e nevojshme për shëndetin politik të qytetarëve të Kosovës demokracinë e dhunuar dhe pastrimin nga minjtë e politikës nëntokësore dhe ajrin e helmuar nga injorantët politikë, disa prej tyre aksidentalisht të zgjedhur deputetë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

'Dardanët' përgatiten për kualifikueset, paralajmërojnë fitore ndaj Gjeorgjisë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall është duke u përgatitur për dy ndeshjet e para kualifikuese për "Euro 2026" që do t'i zhvillojë gjatë këtij muaji. "Dardanët" janë pjesë e Grupit 10, ku bëjnë pjesë edhe Franca, Gjeorgjia dhe Bullgaria. Kosova ndeshjen e parë të premtën e zhvillon ndaj Gjeorgjisë në Tbilisi, ndërsa më 17 dhjetor do të luajë në shtëpi kundër Bullgarisë. Kjo është hera e parë që Kosova kualifikimet për Evropian i nis nga "Main Raund", ku 10 ekipet e renditura në pozitën e parë i bashkohen Letonisë dhe Lituaniës si nikoqire në finalen e "Euro 2026", derisa tetë ekipet më të mira të vendeve të dyta luajnë në "play-off" në shtator për katër biletat e tjera të Evropianit.

Përzgjedhësi Agon Ramadani, duke folur për këto kualifikime, ka shprehur optimizëm se Kosova do të paraqitet mirë, pse jo edhe të shkaktojë befasi. "Ne jemi në përgatitje të mira për këto kualifikime. Sidomos me ndeshjet e fundit që i kam zhvilluar. Shtatë ndeshje miqësore na kanë dhënë një pritshmëri dhe një besim jashtëzakonisht të mirë. Kemi ngritje të cilësisë dhe kemi lojtarë të ri që janë komponuar mirë me ekipin. Bashkërisht do të mundohemi të shkaktojmë befasi, pasi kemi kualitet dhe do të



provojmë deri në fund të bëjmë diçka më shumë se herëve të tjera. E kemi një synim të qartë, pasi besojmë se do të paraqitemi denjësisht. Ndeshjet miqësore i kemi zhvilluar me kombëtare të forta, të përafërta për nga cilësia me Gjeorgjinë që e kemi ndeshjen e parë. Në kualifikimet e tjera kishim një frikë para këtyre kampanjave dhe tash kjo ka kaluar dhe besojmë se s'do të jemi inferiore ndaj këtyre kundërshtarëve", ka thënë Ramadani.

Për ndeshjet kualifikuese foli edhe lojtari me përvojë të madhe Ramadan Alaj, i cili beson në fitore ndaj Gjeorgjisë e më pas edhe ndaj

Bullgarisë. "Si ekip përfaqësues i futsalit në arenën ndërkombëtare kemi bërë gjithmonë ndeshje të mira. Për shkak të arritjeve të mëhershme tash do të bëjmë gara në 'Main Raund' dhe do të mundohemi të paraqitemi sa ma mirë edhe pse në këtë grup kemi kundërshtarë të fortë si ekipi i Francës, i Gjeorgjisë, po ashtu edhe Bullgaria. Ekipi është i motivuar dhe shpresojmë të fitojmë në Gjeorgji dhe pastaj këtu si vendas me Bullgarinë shpresojmë të fitojmë", ka thënë Alaj.

Në linjë me Ramadanin dhe Alajn janë edhe Bajram Ramadani dhe Mërgim Dervishaj që do ta mbyllin me sukses këtë cikël kualifikues.

SHKURT

FHK-ja më 26 dhjetor shpall më të mirët e vitit

Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës e ka mbajtur mbledhjen e radhës, drejtuar nga presidenti Eugen Saraçini. Bordi ka vendosur që ceremonia "Laureatët 2024" të mbahet më 26 dhjetor nga ora 18:00 në "Hotel International Prishtina". Ceremonia tradicionalisht është mbajtur në javët e para të vitit pasues, por në fund të këtij viti të suksesshëm u vendos që më të mirët të shpallen në ditët e fundit të dhjetorit. Ceremonia "Laureatët e Vitit" mbledh hendbollistë e hendbolliste, trajnerë, drejtues e punëtorë të sportit tonë. Është një moment i rëndësishëm në të cilin shënohen sukseset e arritura gjatë një viti kalendarik dhe shpërblehen më të mirët. Në mbledhjen e Bordit është diskutuar edhe për çështje të tjera me rëndësi për hendbollin e Kosovës.

Xhaka: Duam të jemi në mesin e tetë skuadrave më të mira

Bayer Leverkuseni ka regjistruar një fitore të madhe në Ligën e Kampionëve të martën duke e mposhtur Interin (1-0). Granit Xhaka ishte një nga lojtarët me performancën më të mirë kundër italianëve dhe pas ndeshjes ai ka pranuar se triumfi ndaj Interit i motivon për të kërkuar edhe më shumë. "Tani duam të jemi në mesin e tetë skuadrave më të mira", ka thënë Xhaka.

Mërgim Mavraj, kandidat për deputet i 'Listës për familje'

Mërgim Mavraj i ka hyrë politikës. Ai do të jetë kandidat për deputet në zgjedhjet e 9 shkurtit. Ish-futbollisti i kombëtares shqiptare zyrtarisht ka aderuar në "Listën për familjen", që udhëhiqet nga dy ish-deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, Eman Rrahmani dhe Visar Korenica. Kjo është konfirmuar për "Klankosova.tv" nga Eman Rrahmani. "Po, Mërgim Mavraj do të jetë kandidat për deputet nga Lista për familjen", ka thënë Rrahmani.

Eksperti i transferimeve: Asani do të largohet nga Gwangju

Jasir Asani ka deklaruar se kishte mbyllur sezonin pas një dëmtimi që mori, duke mos qenë në dispozicion të skuadrës javën e fundit të kampionatit. Megjithatë mediet ishin të sigura se ai mesazh ishte një sinjal lamtumire, me Asanin që e kishte mbyllur aventurën te skuadra koreane. Për t'i dhënë më shumë zë kësaj hipoteze ka menduar edhe eksperti i merkatos në Korenë e Jugut, Dario Focardi. Sipas tij, sulmuesi i Kombëtares shqiptare me shumë mundësi do të largohet nga ekipi aktual, teksa tri klube janë në garë për shërbimet e tij. Jeonbuk në Korenë e Jugut, Vissel Kobe dhe Yokohama F Marions në Japoni, janë skuadrat e interesuara për shërbimet e shqiptarit. Klubi i Gwangjus kërkon që të shesë për të përfituar të ardhura dhe "mëngjarashi" nga Shkupi është gati të shitet. Skuadra e Gwangjus për shërbimet e shqiptarit kërkon 1 milion euro. Pritet të shihet se ku do ta vazhdojë karrierën Asani, me pistën "Evropë" që për momentin nuk ekziston.

Shorti i 1/8 së finales së Kupës, dy përballje interesante

PRISHTINË, 11 DHJETOR - Në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës është hedhur shorti për fazën e 1/8 së finales së Kupës së Kosovës. Në këtë fazë të garës janë kualifikuar 16 skuadra, nëntë nga Superliga dhe shtatë nga Liga e Parë që synojnë të kalojnë tutje. Tanimë 16 skuadrat që për synim kanë ta fitojnë trofeun e çmuar të Kupës kanë mësuar kundërshtarët. Përballje e zjarrtë është edhe ajo në mes të Prishtinës dhe Suharekës. Drita do të përballet me Dukagjinin, ndërsa Gjilanin e pret një udhëtim i vështirë te Vëllaznimi. Ferizaj do të përballet me Rilindjen, ndërsa Llapin pret Vushtrrinë. Takim tjetër interesant është ai në mes të Trepçës dhe Drenicës, që po luftojnë edhe për t'u futur në Superligë nga Grupi A i Ligës së Parë.

1/8 e finales në Kupën e Kosovës:



Vëllaznimi-Gjilani, Feronikeli '74-Prishtina e Re, Llapi-Vushtrria, Prishtina-Suhareka, Ferizaj-Rilindja 1974, Drita-Dukagjini, Dinamo-Malisheva, Trepça-Drenica.

Abrashi rinovon kontratën me Grasshoppersin

CYRËH, 11 DHJETOR - Repreruesi i Shqipërisë, Amir Abrashi, e ka vazhduar kontratën me Grasshoppersin edhe për një vjet. Lajmin për rinovimin e kontratës e ka bërë klubi zviceran përmes një njoftimi. "Grasshopper

Club Zurich ka kënaqësinë të njoftojë për vazhdimin e kontratës me kapitenin Abrashi. Mesfushori 34-vjeçar do të qëndrojë te GCZ edhe për një sezon. Me lidhshpimin, pasionin dhe përkushtimin e tij, Amir

Abrashi është pjesë e pazëvendësueshme e skuadrës. Ai luajti për Grasshoppersin nga 2010 deri më 2015 para se të transferohej në SC Freiburg në Bundesligë. Në total ai plotësoi 258 paraqitje për GC

Zurich", thuhet në njoftimin e Grasshoppersit. Ndërkohë, i lumtur për rinovimin e kontratës është shprehur edhe 34-vjeçari. "GC Zurich do të thotë shumë për mua dhe jam krenarë që vazhdoj ta mbaj logon në gjoks. Do të



bëj më të mirën dhe do të luftoj gjithmonë për klubin", ka thënë Abrashi.

Ancelotti: Fitorja vlen më shumë se tri pikë. Gasperini: Për ne ka zhgënjim

BERGAMO, 11 DHJETOR - Pas dy humbjeve radhazi në Ligën e Kampioneve, Real Madridi reagoi fuqishëm duke dalë me tri pikë nga transferta përballë Atalantas. Carlo Ancelotti shijoi një Mbappe në versionin e tij më të mirë për sa kohë ishte në fushë, por jo vetëm Mbappe, sepse i gjithë ekipi u përgjig mirë. Tekniku italian u shfaq i kënaqur në konferencë për shtyp pas kësaj fitoreje. "Ky sukses na lejon të shohim përpara me pozitivitet. Të arrijmë mes tetë ekipeve të para mbetet ende e komplikuar. Ekipi kishte guxim të shihte gjithnjë përpara. Ky sukses vlen më shumë sesa tri pikë. Mbappe? Nuk duket një dëmtim serioz. Për fat të keq, dëmtimet e shumta nuk na lejojnë të japim më të mirën tonë, por objektivi është të jemi gjallë deri për Krishtlindje", u shpreh




Ancelotti. Sigurisht që kjo humbje i lë një shije të hidhur Gasperinit, por trajneri i Atalantas e sheh "gotën gjysmë plotë", kjo ishte një humbje nga ku mund të nxjerrin mësim. "Besoj se ju argëtuam. Të dy skuadrat u përpoqën ta fitonin ndeshjen në mënyrën e

tyre. Për ne ka pak zhgënjim, por nga këto ndeshje mund të mësohet diçka. Dalim të humbur nga kjo ndeshje, por numrat nuk na mungojnë. Kjo është një pikënisje për të hedhur hapa të rëndësishëm përpara në të ardhmen", ka deklaruar Gasperini.

Oklahoma dhe Milwaukee kalojnë më tej në NBA Cup

OKLAHOMA, 11 DHJETOR - Mbrëmja e së martës në NBA ishte e gjitha e dedikuar NBA Cup. Turneu i ri i aplikuar për herë të dytë nga organizatorët e NBA-s ka mbërritur në fazën çerekfinale. Dy sfidat e para u zhvilluan të martën në mbrëmje. Sfidat më interesante ishin ato në mes të Oklahomas dhe Dallas Mavericksit. Vendasit triumfuan me shifrat 118-104 duke prerë një biletë për në gjysmëfinale të turneut e duke eliminuar kështu finalistët e vjetshëm të udhëhequr nga Luka Donçiq. 39 pikë dhe 8 topa në tabelë për "yllin" e Oklahomas Shai Alexander, ndërkohë 16 pikë të Donçiqit e 17 të Irvingut ishin shumë pak për Dallasin në këtë mbrëmje. Një biletë për në gjysmëfinale të NBA Cup siguroi



edhe Milwaukee Bucks, teksa skuadra e udhëhequr nga Giannis Antetokounmpo mundi me rezultatin 114-109 Orlando Magic. Basketbollisti grek u dallua falë 37 pikëve të tij dhe 7 rebaundeve, duke qenë i saktë në 15 nga 24 goditjet nga parketi.

Deçiziv në fund të sfidës edhe Damian Lillard, falë 11 pikëve të tij në dy minutat e fundit të sfidës. Dy çerekfinalet do të zhvillohen sonte janë New York Knicks - Atlanta Hawks dhe Houston Rockets - Golden State Warriors.

SHKURT

Alonso: E merituar fitoren kundër Interit

Trajneri i Bayer Leverkusenit, Xavi Alonso, është shprehur i kënaqur pas fitores 1-0 ndaj Interit në Ligën e Kampioneve. Strategu spanjoll është i bindur se kanë shënuar fitore me meritë. "Jemi shumë të kënaqur për këtë fitore kundër një ekipi të madh. Nuk e mendoja se do të kishim 20 raste kundër një ekipi si Interi. Mendoj se e merituar fitoren", ka thënë Alonso.

Inzaghi: Na mungoi kualiteti

Kampioni i Italisë, Interi, pësoi humbje nga Bayer Leverkuseni (1-0) në Ligën e Kampioneve. Simone Inzaghi ka thënë se skuadrës së tij i mungoi kualiteti. "Nuk ishte një nga ndeshjet tona më të mira, për më tepër që përpara kishim një rival me shumë vlera. Për fat të keq, na mungoi kualiteti në 25 metrat e fundit", u shpreh Inzaghi. Interi është në vendin e katërt me 13 pikë, derisa i ka edhe dy ndeshje për t'i zhvilluar.

Buffon: Finalja e vitit 2006 është ndeshja më e rëndësishme e jetës sime

Legjenda e portës së Italisë, Gigi Buffon, e ka cilësuar finalen e vitit 2006 si më të rëndësishmen në karrierën e tij futbollistike. "Kupa e Botës në Gjermani ishte një nga momentet më prekëse në historinë time me ekipin kombëtar. Ajo më bëri të kuptoj sa shumë italianët, sidomos ata jashtë vendit, shihnin tek ne një pikë referimi që u lejonte të krenoheshin me identitetin. Finalja e vitit 2006? Ndeshja më e rëndësishme e jetës sime", ka thënë Buffoni. "Përfaqësimi i Italisë, veshja e fanellës axurre, ndjenja e unitetit pas arritjes në Dortmund, sikur donte të thoshte: T'ia dhurojmë këtë trofe vetes, ta fitojmë së bashku. Ishte fitore e fuqisë së unitetit, që Italia di ta arrijë kur është koha për të luftuar", ka deklaruar Buffoni, shefi i delegacionit të ekipit kombëtar italian, në hapjen e ekspozitës "Hijet e Kaltra", në praninë e studentëve të dy shkollave të mesme të Romës.

Reali heq dorë nga transferimi i Davies, synon Hernandezin

Real Madridi e ka identifikuar Theo Hernandezin si një alternativë ndaj Alphonso Davies, sipas "Calciomercato". Gjigantët e La Ligas po kërkojnë të nënshkruajnë me një mbrojtës të ri të majtë në vitin 2025 dhe e ndjekin prej kohësh kanadezin. Davies është në vitin e fundit të kontratës së tij me Bayern Munchenin dhe nuk ka nënshkruar ende një marrëveshje të re. "Los Blancos" po planifikon ta marrë me kosto zero në fund të sezonit. Megjithatë, duket se lojtari është më afër rinovimit të kontratës me Bayernin dhe për këtë arsye duket se Reali ka kthyer sytë nga Theo Hernandezi. Francezi kaloi dy sezone me "Los Blancos", por u largua për t'iu bashkuar Milanit më 2019. Që atëherë ai është transformuar në një nga mbrojtësit e majtë më të mirë në Itali. Kontrata e lojtarit skadon në vitin 2026 dhe kuqezinjët janë të etur për ta lidhur atë me një marrëveshje të re. Megjithatë, ata, gjithashtu, mund të jenë të gatshëm ta lënë atë të largohet për 50 milionë euro verën e ardhshme.

Guardiola: Nuk do të drejtoj asnjë ekip tjetër pas Cityt

Pep Guardiola ka deklaruar se Manchester City do të jetë klubi i fundit që ai do të drejtojë në karrierën e tij si trajner, por nuk e ka përjashtuar mundësinë e marrjes së drejtimit të një kombëtareje në të ardhmen. Spanjollit së fundmi ka

nënshkruar një kontratë të re me Cityn deri në verën e vitit 2027, çka do ta çojë atë në 11 vjet në krye të skuadrës. Guardiola ka fituar 15 trofe të mëdhenj që kur u bashkua me Cityn në vitin 2016 dhe është raportuar gjerësisht se gjatë

verës atij iu afrua mundësia për ta marrë drejtimin e Kombëtares së Anglisë. "Do të vijë një moment kur do ta ndiej se mjafton dhe aty do të ndalem, pa dyshim. Nuk do të bashkohem me një tjetër klub. Nuk po flas për një të ardhme

shumë të largët, por nuk do të shkoj në një vend tjetër për të drejtuar një klub tjetër. Nuk do të kisha energjinë. Tani jam ende këtu, por - të nisësh gjithçka nga fillimi, gjithë procesin e stërvitjes; jo, jo, jo. Një Kombëtare? Mund të

ndodhë, por është ndryshe. Nuk është çdo ditë, me ndeshje çdo tri ditë. Mendoj se do të duhet të ndalem. E imagjinoj veten si ata shefat e kuzhinës që shkojnë në vende të tjera për të parë si funksionojnë gjërat", ka thënë Guardiola.

WENG FAT POULTRY SH.P.K
High Quality Duck Products

Thirrje për aplikim

Weng Fat Poultry SH.P.K., NUI 811014761, po kërkon ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

Blerja dhe instalimi i paneleve solare termike me kapacitet minimumi 40 KW

Blerja dhe instalimi i paneleve solare fotovoltaike kapacitet minimumi 40 KW

Nr. Prokurimit 02/24 Weng Fat Poultry SH.P.K

Emri: Weng Fat Poultry SH.P.K

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit:

info@br-dtckosovo.com

Adresa: Polac, Skenderaj, Republika e Kosovës

Tel: +38343900082;

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 14:00, në Adresë:

Weng Fat Poultry SH.P.K., Fshati Polac, Skenderaj, Republika e Kosovës.

Thirrje për aplikim

“Konsoni - m” sh.p.k., NUI 811127316, po kërkon ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

Kombi transportues me mundësi instalimi të frigos

Nr. Prokurimit 002/24 “Konsoni - m” sh.p.k

Emri: “Konsoni - m” sh.p.k

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit:

konsoni@gmail.com , Adresa: Livoc i Ulet, Gjilan, Republika e Kosovës, Tel: +383 (0) 044 50 40 40

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 15:00, në Adresë: “Konsoni - m” sh.p.k., Livoc i Ulet, Gjilan, Republika e Kosovës, Republika e Kosovës.

Thirrje për aplikim

“Konsoni - m” sh.p.k., NUI 811127316, po kërkon ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

Blerja dhe instalimi i paneleve solare fotovoltaike kapacitet minimumi 126 KW

Nr. Prokurimit 001/24 “Konsoni - m” sh.p.k

Emri: “Konsoni - m” sh.p.k

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit:

konsoni@gmail.com, Adresa: Livoc i Ulet, Gjilan, Republika e Kosovës, Tel: +383 (0) 044 50 40 40

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 15:00, në Adresë:

“Konsoni - m” sh.p.k., Livoc i Ulet, Gjilan, Republika e Kosovës, Republika e Kosovës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nakije Juniku nga Gjakova shpall të gjata dhe të shkurtra. Informata në pavlefshme diplomën e sh.m.t. tel: 049\44-888-801 (viber) “Nexhmedin Nixha” Gjakovë Tregti.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Sejd Rexhepi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Endrit Dhomi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

